

Përshëndetje,

Në lidhje me kërkesën tuaj sqarojmë sa vijon:

1. Për pyetjet 1 dhe 3, të kërkesës suaj:

“1. Mbi ç’baze ligjore DAP-i e konsideroi të plotësuar kriterin prej 5 vitesh përvojë drejtuese për pranimin e E. L. në TND në tetor 2025, kur përvoja e saj e mirëfilltë si drejtore ishte vetëm 21 muaj?”

3. Meqenëse Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil konfirmon se DAP-i është përgjegjësi i vetëm për verifikimin e kriterëve të TND-së, si e llogariti DAP-i përvojën drejtuese të subjektit E. L. prej 5 vitesh, kur CV-ja e saj zyrtare vërteton se znj. L. ka nisur punë si drejtuese (në AKBN) vetëm në janar të vitit 2024?”

Në zbatim të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, VKM nr. 118/2014, të ndryshuar, VKM-në nr. 470, datë 31.7.2025, “Për hapjen e procedurës së pranimi të drejtpërdrejtë në TND edhe për kandidatë të tjerë jashtë shërbimit civil dhe për përdorimin e procedurës së pranimi të drejtpërdrejtë në TND, për vitin 2025” dhe shpalljes publike për këtë procedurë, ju sqarojmë se në procedurën për pranimin në Trupën e Nivelit të Lartë Drejtues të zhvilluar në periudhën gusht – nëntor 2025, kandidatët mund të aplikojnë me eksperiencat e tyre nga brenda shërbimit civil ose me eksperiencat e tyre nga jashtë shërbimit civil, duke plotësuar kriteret si vijon:

- Kandidatët që konkurojnë me eksperiencat nga brenda shërbimit civil duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

“a. Të kishin të paktën 1 (një) vit përvojë pune në pozicione të nivelit të mesëm drejtues **ose të barazvlefshme me to** (një nga klasat e pagave që i përkasin kategorisë II);

b. Të mos kishin masë disiplinore në fuqi, që nuk ishin shuar sipas legjislacionit përkatës.”

- Kandidatët që konkurojnë me eksperiencat e tyre nga jashtë shërbimit civil duhet të plotësojnë kriteret minimale si vijon:

“ a. Të plotësojnë kushtet e përgjithshme të pranimi në shërbimin civil, të përcaktuara në shkronjat “a” deri në “dh”, të nenit 21, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar;

b. Të zotëronin një diplomë të nivelit “Master i shkencave” apo “Master profesional të përfituar në fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 (dy) vite akademike”, ose të barasvlershme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë. Diplomat, të cilat janë marrë jashtë vendit duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njësimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi;

c. Të kishin të paktën **3 (tre) vjet përvojë pune** në pozicione të mesme drejtuese **ose të barasvlershme** në:

- *institucione të administratës publike;*

- institucione bankare të nivelit të dytë e që aktualisht nuk kanë detyrime ndaj shtetit ose nuk janë në proces kundër tij;

- shoqëri tregtare, të cilat, sipas legjislacionit në fuqi, konsiderohen si biznes i madh e që aktualisht nuk kanë detyrime ndaj shtetit ose nuk janë në proces kundër tij;

- organizata jofitimprurëse, të cilat kanë të paktën 5 (pesë) vjet që janë krijuar.

Përrjashtimisht, për kandidatët nga jashtë shërbimit civil, të cilët kishin punuar dhe/ose punonin:

i. në institucione ndërkombëtare brenda vendit;

ii. në profesion jashtë vendit;

iii. pedagogë në institucione të arsimit të lartë;

iv. avokatë, noterë apo kontabilistë, të miratuar brenda ose jashtë vendit;

kriteri i përvojës në punë të jetë të paktën 5 (pesë) vjet në këto institucione ose në profesion.

ç. Të mos kishin procese gjyqësore, civile, penale, administrative, të cilat janë në proces, si edhe të mos jenë në ndjekje penale nga prokuroria.

d. Të mos kishin masë disiplinore në fuqi, që nuk janë shuar sipas legjislacionit përkatës.”

Fillimisht, vlen të theksohet se edhe në kriterin e vjetërsisë për ata që kandidojnë si nga brenda shërbimit civil, ashtu edhe në kriterin e vjetërsisë për nga jashtë shërbimit civil, në çdo rast përveç nivelit që i përket pozicionit (pra nivelit të mesëm drejtues, ku klasifikohen pozicionet klasike “drejtor drejtorie”) vendimi i Këshillit të Ministrave merr në konsideratë edhe pozicionet e barazvlefshme me pozicionet “drejtor drejtorie”.

Gjithashtu, në vlerësimin e plotësisimit të kriterit të eksperiencës, llogaritja e viteve bëhet

mbi bazën e aplikimit nga brenda apo jashtë shërbimit civil, pra nëse një kandidat ka eksperiencë edhe nga jashtë edhe nga brenda shërbimit civil, këto eksperiencë nuk mbledhen me njëra tjetrën, por konsiderohet eksperiencë më e favorshme. Kjo sepse, në rastin e TND-së procedura e konkurimit është e ndryshme dhe nuk klasifikohet si procedurë e ngritjes në detyrë. Procedura e ngritjes në detyrë, sipas legjislacionit për nëpunësin civil është e dedikuar vetëm për kategorinë e nivelit të ulët drejtues dhe të mesëm drejtues, dhe në të kërkohet që kandidati që aplikon për ngritje në detyrë duhet të jetë nëpunës civil i konfirmuar, me përjashtim të pozicioneve të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave për vitin kalendarik përkatës, ku përveç nëpunësve civilë të konfirmuar mund të aplikojnë edhe kandidatë të cilët nuk janë nëpunës civilë.

Më tej, sqarojmë se përcaktimi i barazvlefshmërisë bëhet ose nëpërmjet klasës së pagës së cilës i përket pozicioni (aktualisht klasat II-1 dhe II-2, që i përkasin kategorisë II – niveli i mesëm drejtues), ose nëpërmjet vlerës së pagës bazë mujore, në rastet kur kjo pagë është e përcaktuar me vlerë absolute dhe jo me kategori page. Kjo për arsye se në administratën publike, pjesë e shërbimit civil ose jo, përveç emërtesave klasike “specialist”, “përgjegjës sektori”, “drejtor drejtorie”, “drejtor drejtorie të përgjithshme”, “drejtor departamenti”, “sekretar i përgjithshëm” ka edhe emërtesa të tjera të veçanta dhe të ndryshme nga emërtesat klasike, emërtesa këto që klasifikohen në një nga klasat e emërtesave klasike, apo në një vlerë të barabartë ose më të lartë page se sa ajo e emërtesave klasike. Këto emërtesa të veçanta janë të përcaktuara në institucione të administratës publike, sepse ka pozicione pune që megjithëse mirëfilli në kuptimin hierarkik të tyre nuk mund të emërtohen si “përgjegjës sektori”, “drejtor drejtorie”, “drejtor drejtorie të përgjithshme”, “drejtor departamenti”, “sekretar i përgjithshëm”, puna që kryhet në këto pozicione të veçanta, për nga rëndësia e punës, pasojës që puna e tyre jep në realizimin e misionit të institucionit, vendimmarrjes së tyre në proceset e punës, si dhe veprimtarisë koordinuese brenda të njëjtit institucion apo me institucione të tjera të administratës publike, është e njëjtë me pozicionet klasike drejtuese. Pra, klasifikimi në pagë i pozicioneve të punës nuk bazohet vetëm duke konsideruar emërtimin e pozicionit dhe komponentin e drejtimit, por edhe komponentët e tjerë të përmendur. Kjo është e shprehur qartësisht edhe në ligjin nr. 35/2023, ku përcaktohen edhe parimet për përcaktimin e pagave dhe ku, një ndër parimet, është edhe “c) të sigurojnë një shpërblim të drejtë dhe të barabartë për punë të njëjta”. Ndër pozicionet e punës me emërtesa të veçanta të ndryshme nga emërtesat klasike, pjesë të pozicioneve të shërbimit civil ose jo, që janë të barazvlefshme me pozicionet me emërtesa klasike të kategorisë së ulët drejtuese, të mesme drejtuese apo të lartë drejtuese, përmendim “drejtor kabineti”, “këshilltar”, “koordinator”, “ekspert”, “jurist në Kryeministri”, “avokat shteti”, “analist”, “ndihmës në kabinet”, “zëdhënës”, “ndihmësinspektor i lartë”, “inspektor”, “ndihmëskomisioner kategoria e parë në

institucionin e Avokatit të Popullit”, “ndihmëskomisioner kategoria e dytë në institucionin e Avokatit të Popullit”, etj. Theksojmë se në çdo rast përcaktimi i klasës së pagës apo vlerës absolute të pagës, që passjell edhe barazvlefshmërinë e pozicioneve të veçanta bëhet me akt ligjor apo nënligjor të miratuar nga organi që e ka këtë të drejtë sipas ligjit nr. 35/2023, të ndryshuar.

Gjithashtu, vlen të sjellim në vëmendje se sa më sipër në lidhje me barazvlefshmërinë aplikohet aktualisht dhe është aplikuar gjithmonë jo vetëm në rastin e konkurimit për anëtarë të TND-së, por edhe në të gjitha procedurat e tjera të shërbimit civil.

Ndërkohë, në lidhje me aplikimin e znj. L., ju sqarojmë se ajo ka aplikuar dhe ka konkurruar me eksperiencat e saj jashtë shërbimit civil, meqënëse nuk plotësonte kushtin e të qenit të paktën 1 vit në pozicione pune të shërbimit civil në nivel të mesëm drejtues apo të barazvlefshëm me to (një nga klasat e pagave që i përkasin kategorisë II).

Për sa më sipër, vitet e eksperiencës së znj. L. janë llogaritur si nëpunëse e administratës publike në pozicione jo të shërbimit civil, ku ajo plotësonte kriterin minimal, citojmë “c. **Të kishin të paktën 3 (tre) vjet përvojë pune në pozicione të mesme drejtuese ose të barasvlershme në institucione të administratës publike**”. Konkretisht, sipas jetëshkrimit të saj dhe verifikimit me librezën e punës, rezulton se përveç pozicioneve të tjera si “drejtor kabineti i drejtorit të përgjithshëm të tatimeve”, “këshilltar në kabinetin e ministrit të financave”, “drejtor drejtorie në AKBN” (të gjitha këto pozicione të barazvlefshme me të paktën pozicione të nivelit të mesëm drejtues), në periudhën janar 2019 – shtator 2022, pra një periudhë mbi 3 vjeçare, znj. L. ka qenë e punësuar në pozicionin “avokat shteti” në Avokaturën e Përgjithshme të Shtetit. Në lidhje me barazvlefshmërinë e pozicionit “avokat shteti”, në këndvështrim të sa argumentuar më sipër, sqarojmë sa vijon:

- a. Deri në nëntor të vitit 2018, referuar vendimeve përkatëse të pagave (më i fundit VKM nr. 187/2017) pozicioni “avokat shteti” ka qenë i klasifikuar në klasën e pagës II-b, klasë kjo ku klasifikoheshin edhe pozicionet e nivelit të mesëm drejtues “drejtor drejtorie”, pra pozicion i barazvlefshëm me pozicione të nivelit të mesëm drejtues “drejtor drejtorie”.
- b. Nga dhjetori i vitit 2018 e në vijim, pagat e avokatëve të shtetit përcaktohen në raport me pagën e Kryeministrit, sipas nenit 27, të ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008, i ndryshuar. Sipas këtij ligji u rivlerësua rëndësia e pozicionit “avokat

shteti”, duke e klasifikuar atë në hierarkinë e përgjithshme të pozicioneve të punës në administratën publike, të barazvlefshëm me të paktën pozicionin e nivelit të lartë drejtues “drejtor i përgjithshëm”.

2. Për pyetjen 3, të kërkesës suaj:

“3. DAP deklaron se nuk mban përgjegjësi për komandimin e znj. L. në maj 2025 pasi është procedurë e brendshme e institucionit. Mirëpo, a nuk ka detyrim DAP-i të refuzojë emërimin përfundimtar të një personi, kur konstaton se ky person ka ushtruar detyrën faktike (komandimin) pa pasur statusin e nëpunësit civil, duke shkelur parimin e hyrjes në shërbim vetëm me konkurs?”

Siç ju kemi shpjeguar edhe në korrespondencën e mëparshme, aktet e komandimit (ngarkimit me detyra) nuk nxirren nga Departamenti i Administratës Publike, por nga vetë institucionet, të cilët nuk kanë detyrimin të informojnë DAP-in. Për këtë arsye DAP-i nuk i disponon ato.

Ndërkohë, ju sqarojmë se bazuar në përcaktimet e legjislacionit për nëpunësin civil, kandidatët që aplikojnë për një pozicion pune të kategorisë ekzekutive, të ulët drejtuese apo të mesme drejtuese, apo për t’u bërë anëtarë të TND-së, vlerësohen për t’u kualifikuar ose jo në procedurën e konkurimit mbi bazën e kriterëve të përgjithshme të përcaktuara në nenin 21, të ligjit nr. 152/2013, të ndryshuar dhe në kriteret e veçanta të përcaktuara në shpalljet për konkurim midis të cilave edhe kriteri i nivelit dhe llojit të diplomës dhe kriteri i eksperiencës në punë.

Në përfundim të një procedure konkurimi, kandidatët që janë shpalluar fitues emërohen nga DAP-i në pozicionet për të cilat kanë konkuruar. Aktet e emërimit nuk nxirren apo anulohen nga DAP-i në rastet kur pasi është zhvilluar procedura: (i) me idicie verifikohet se kandidati ka problematika të provuara me vërtetësinë e dokumentave të dorëzuara (gjë që përbën shkak për mosplotësim të kriterëve të përgjithshme apo të veçanta) apo; (ii) kur është në kushtet e ndalimit për të ushtruar funksione publike sipas ligjit nr. 138/2015, i ndryshuar dhe vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë.

Edhe në rastin e emërimit të një anëtari të TND-së, në një pozicion të nivelit të mesëm drejtues, vlerësimi për emërimin përfundimtar të tij bëhet mbi të njëjtat kritere si edhe për pozicionet e tjera.

Si përfundim, ju sqarojmë se, kërkesa juaj për informim është regjistruar në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve 2026 të DAP-it, me numrin rendor 9, sipas detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", të ndryshuar. Për çdo kërkesë tjetër për informim ju mund t'i drejtoheni adresës së kontaktit info@dap.gov.al.